

Inspektimet shkollore

Udhëzues për prindërit dhe kujdestarët

Pse Ofsted i inspekton shkollat?

Ne i inspektojmë shkollat për të siguruar informata për prindërit, për t'i promovuar përmirësimet dhe ta ngrisim përgjegjësinë e shkollave për të hollat publike të cilat i pranojnë. Inspektimet shkollore parashihen me ligj. Ne sigurojmë vlerësim të pavarur për cilësinë dhe standardet e arsimit në shkolla dhe i kontrollojmë të arriturat e nxënësve, në raport me mundësinë dhe kapacitetin e tyre.

Kur bëhen inspektimet dhe sa zgjasin?

Ne i inspektojmë shkollat të paktën çdo tre vite. Shumica e shkollave informohen dy ditë para inspektimit. Inspektimi zgjatë një ose dy ditë.

Kush i inspekton shkollat?

Inspektimet kryhen nga Inspektorët e Madhërisë së saj (HMI) dhe Inspektorët plotësues (AI). Të gjithë inspektorët janë trajnuar për punë dhe vlerësuar sipas standardeve tona.

Çka ndodhë gjatë inspektimit?

Inspektorët e analizojnë vetëvlerësimin e shkollës dhe i analizojnë rezultatet dhe përparimin e nxënësve. Ata bisedojnë me drejtorët, udhëheqësit, kuadrin dhe nxënësit dhe i marrin parasysh mendimet e juaja si prind ose kujdestar. Ata i përcjellin disa orë mësimore dhe konstatojnë se si menaxhohet dhe udhëhiqet shkolla.

Si mund t'i bëj publike mendimet e mia?

Në rast se jeni prindër i regjistruar i fëmijës së regjistruar në shkollë, shkolla do tu dërgojë letër me pyetësorin tonë. Ju mund t'i shprehni mendimet tuaja duke e plotësuar pyetësorin dhe duke i kthyer përgjigjet tek ekipi inspektues në shkollë. Inspektorët do t'i shfrytëzojnë pikëvështrimet tuaja gjatë vlerësimit. Pyetësorët mbeten në mirëbesim, por në qoftë se ndonjë përgjigje ngritë ndonjë çështje të lidhur me sigurinë e fëmijëve, inspektorët mund ta publikojnë informatën.

A mund të bisedoj me inspektorët?

Ju mund të keni rastin të bisedoni me inspektorët gjatë inspektimit, për shembull në fillimin e ditës shkollore. Nëpunësit e inspektoratit janë të gatshëm t'ia përcjellin porositë inspektorëve, në rast se nuk mund të bisedoni drejtpërdrejtë. Ju lutemi mbani në mend që inspektorët nuk mund të merren me ankesat për çdo nxënës ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të cilat i keni me shkollën.

Çka ndodh pas inspektimit?

Ne i vlerësojmë shkollat me nota prej 1 deri në 4:

- nota 1 (e dalluar)
- nota 2 (mirë)
- nota 3 (mjaftueshëm)
- nota 4 (pamjaftueshëm).

Inspektori-udhëheqës ia raporton vlerësimet drejtorit ose udhëheqësit. Konstatimet e inspektorëve publikohen në raportin për shkollën, prindërit dhe bashkësinë. Raportet e inspektimit e vlerësojnë efektivitetin e punës së shkollës dhe japin rekomandime për gjërat të cilat duhet t'i bëjnë shkollat për përmirësime plotësuese. Shkolla duhet t'i ndërmerr hapat e nevojshëm për tu siguruar që këtë raport e keni pranuar edhe ju. Raporti e përfshin edhe letrën për nxënësit, ku ceket mendimi i inspektorëve për shkollën dhe gjërat të cilat duhet t'i bëjnë nxënësit për përmirësime. Raporti publikohet edhe në web-faqen tonë: www.ofsted.gov.uk/reports.

Çka ndodh në qoftë se Ofsted konstaton që shkolla është 'e pamjaftueshme'?

Në qoftë se inspektorët konstatojnë që shkolla është e pamjaftueshme, shkolla do të futet në një rën kategori prej të cekurave në vijim:

Masat e posaçme

Kjo do të thotë që shkolla nuk siguron standarde të pranueshme arsimore për nxënësit e saj dhe nuk ka kapacitet për t'i bërë përmirësimet e nevojshme. Inspektorët do ta vizitojnë shkollën rregullisht për ta kontrolluar përparimin e saj, deri në momentin kur shkolla të jetë në gjendje për largim nga kjo kategori. Ne do ta inspektojmë shkollën përsëri pas mesatarisht dy viteve.

Vërejtja për përmirësim

Kjo do të thotë që:

- shkolla nuk siguron standarde të pranueshme arsimore për nxënësit e saj, por ka kapacitet për përmirësime, ose që
- shkolla nuk ka dështuar, por arritjet e saj janë shumë më të pakta se pritjet tona.

Në rast se i japim shkollës vërejtje për përmirësim, ajo do të vizitohet nga inspektori mbikëqyrës dhe do t'i nënshtrohet përsëri inspektimit pas një viti.

Çka ndodh në rast më intereson diçka për inspeksionin?

Ankesat janë të rralla, por ne i shqyrtojmë ato me seriozitet shumë të madh. Më tepër informata mund të gjeni në web-faqen tonë www.ofsted.gov.uk ose duke u lajmëruar në linjën tonë kujdestare në 08456 404045.

Në rast se keni nevojë për ndonjë informatë plotësuese për punën tonë, ju lutemi vizitoni web-faqen ose lajmërohuni në linjën tonë kujdestare.

Çka ndodh në rast se më intereson diçka për shkollën e fëmijës?

Në rast se ju intereson diçka për shkollën e fëmijës, duhet të bisedoni në fillim me mesimdhënësit ose drejtorin. Në rast se nevojitet, mund të bisedoni me këshillin udhëheqës ose organin lokal. Në rast se nuk jeni të kënaqur me përgjigjet, Ofsted mund të jetë në gjendje tu ndihmojë.

Mund të informoheni më tepër duke e vizituar web-faqen tonë ose përmes linjës tonë kujdestare.

Alexandra House
33 Kingsway
London WC2B 6SE
Linja kujdestare: 08456 404045
www.ofsted.gov.uk
Nr i regjistrimit 070015
© Crown copyright 2007

Ky afish është për shkollat të cilat menaxhohen, gjegjësisht shkollat dhe institucionet që financohen me mjete publike.